

**STATUTI**  
**I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“MADE IN BALI”**

**KREU I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri, dhe Themeluesit**

- 1.1 Sot, më 30/03/2021, unë, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin:  
**MADE IN BALI**
- 1.2 Themeluesi i shoqërisë është:
  - a) Z. **Emiljano Dhrami**, shtetas shqiptar, i biri i Pajtimit, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 03 Nëntor 1991, banues në Tiranë identifikuar me leternjoftim nr. 034559380 dhe nr personal J111030460.

**Neni 2**

**Objekti i aktivitetit**

- 2.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:
  - Import dhe eksport
  - Marketim online te produkteve te ndryshme ne rrjete sociale dhe web
  - Shitje online
  - Tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm si mobilje, ndriçues, punime dore etj
  - Veprimtaria e shoqerise do te kryhet sipas lejeve dhe licensave perkatese te leshuara nga Autoritetet e Shtetit Shqiptar.
- 2.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet ose të shtohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve (Ortakut të Vetëm)

**Neni 3**

**Kohëzgjatja**

- 3.1 Aktiviteti i Shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit në Regjistrin Tregtar në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.
- 3.2 Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

  
/EMILJANO DHRAMI/

#### **Neni 4**

##### **Selia e Shoqërisë**

- 4.1 Selia e Shoqërisë është: Rruga Dibrës, pall.10, hyrja22, Ap.8, Tiranë, Shqipëri.
- 4.2 Shoqëria mund të hapë degë, shoqëri bija, zyra përfaqësimi, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose në vende të tjera.
- 4.3 Shoqëria është e aftë të bëjë pjesë në shoqëri të tjera shqipëtare ekzistuese ose në të ardhmen në Republikën e Shqipërisë ose në vende të tjera.

#### **Neni 5**

##### **Forma**

- 5.1 Themeluesit kanë themeluar një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 5.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

#### **Neni 6**

##### **Baza Ligjore**

- 6.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 6.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 7**

##### **Vula**

- 7.1 Shoqëria do të ketë vulën e vetë.
- 7.2 Të gjitha dokumentet e Shoqërisë duhet të shoqérohen nga vula.

#### **KREU II**

##### **Kapitali dhe financimi**

#### **Neni 8**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

- 8.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë.
- 8.2 Kapitali i Shoqërisë është i ndarë në 1 (një) kuotë e cila zotërohet nga:
  - Z. **Emiljano Dhrami**, shtetas shqiptar, i biri i Pajtimit, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 03 Nwntor 1991, identifikuar me leternjoftim nr. 034559380 dhe nr personal J11103046O, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë) Lekë.
- 8.3 Shoqëria mund të zmadhojë dhe zvogëlojë kapitalin sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

EMILJANO  
DHRAMI

## Neni 9

### Transferimi i Kapitalit

- 9.1 Kuotat e kapitalit themeltar të Shoqërisë mund të fitohen apo kalohen nëprmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

- 9.2 Për transferimin e kuotave nuk kërohet miratimi i mëparshëm i shoqerisë.

## Neni 10

### Financimi

- 10.1 Shoqëria me qëllim arritjen e objetit të saj, mund të kërkojë financim nëpërmjet mënyrave ligjore si kredi bankare, hua, financim nga ortaku dhe çdo formë tjetër ligjore.

## KREU III

### Organet Vendimmrrëse dhe Drejtuese

## Neni 11

### Organi Vendimmrrës

- 11.1 Asambleja e Ortakëve (Ortaku i Vetëm) është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.
- 11.2 Asambleja e Ortakëve (Ortaku i vetëm) është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqerisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 11.3 Asambleja e përgjithshme e ortakeve (Ortaku i vetëm) është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

| E MILANO DHRAMI | 

- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shperndarjen e fitimeve
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

#### **Neni 12**

##### **Administrimi**

- 12.1 Asambleja e përgjithshme (Ortaku i Vetëm) emëron një person fizik si administrator të Shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 12.2 Administratori kryen administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë.
- 12.3 Administratori ka të gjitha kompetencat të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët. Ai vepron për emër te shoqërisë dhe nënshkruan çdo dokument të shoqërisë.
- 12.4 Administratori mund të autorizojë përsona të tretë të kryejnë veprime sipas tagrave të dhëna me autorizim apo prokurë.
12. Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme:
  - Z. **Emiljano Dhrami**, shtetas shqiptar, i biri i Pajtimit, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 03 Nëntor 1991, identifikuar me leternjoftim nr. 034559380 dhe nr personal J11103046O.

#### **KREU IV**

##### **Viti finansiar-ekspertet**

#### **Neni 13**

##### **Viti Financiar**

- 13.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qëndrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

#### **Neni 14**

##### **Ekspertët**

- 14.1 Eksperti kontabël i autorizuar zgjidhet më vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të Vetëm). Eksperti ka për detyrë qe të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të

EMILJANO DHRAMI



ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

- 21.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqesë e dorezojë në kohë ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

## KREU V

### Prishja –riorganizimi i shoqërisë

#### Neni 15

##### Prishja dhe likuidimi

- 15.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

#### Neni 16

##### Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

- 16.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

## ORTAKU I VETEM

### I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“MADE IN BALI”

Emiljano Dhrami

EMILJANO DHRAMI

